



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PEQIN

Nr. \_\_\_\_ .Prot.

Peqin, më \_\_\_\_ .09.2019

**SHPLLJE PËR LËVIZJE PARALELE  
NGRITJE NË DETYRË  
NË KATEGORINË E MESME DHE E ULËT DREJTUESE**

**Drejtor i Drejtorisë Juridike, Burimeve Njerëzore dhe TIK**

Në zbatim të nenit 26, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe të Kreut II dhe III, të Vendimit nr. 242, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, Bashkia Peqin shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë për pozicionin:

**1. Drejtor i Drejtorisë Juridike, Burimeve Njerëzore dhe TIK - Kategoria: II-b**

*Pozicioni më sipër, i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.*

**PËR TË DY PROCEDURAT (LËVIZJE PARALELE, NGRITJE NË DETYRË)  
APLIKOHET NË TË NJËJTËN KOHË!**

**10/10/2019**

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

**LËVIZJE PARALELE**

**15/10/2019**

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

**NGRITJE NË DETYRË**

**Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin/et si më sipër është:**

- Mbikëqyr dhe menaxhon punën e sektorëve të Drejtorisë Juridike;
- Përcakton objektivat dhe planifikimin e veprimtarisë së drejtorisë;
- Raporton te eprori direkt lidhur me rezultatet e drejtorisë;
- Identifikon nevojat për zhvillimin e politikave dhe bën rekomandime brenda sektorëve të drejtorisë;
- Udhëzon stafin në përmbushjen e aktivitetit të përditshëm të drejtorisë dhe siguron që kjo veprimtari të jetë në përputhje me legjislacionin, politikat institucionale dhe standardet përkatëse;
- Përfaqëson institucionin në takime pune, konferenca apo e delegon këtë të drejtë brenda drejtorisë;
- Vendos mbi pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Drejtorisë Juridike në grupe pune, apo komisione të ndryshme që mund të krijohen.

## **1 LËVIZJA PARALELE**

---

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

### **1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA**

---

**Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:**

- a- Të jenë nëpunës civilë të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori II-b;
- b- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”.

**Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:**

- a- Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Shkenca Juridike. Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë;
- b- Të kenë të paktën 3 vjet përvojë pune në profesion;
- c- Të kenë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.

### **1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

---

**Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:**

- a - Jetëshkrim i plotësuar;
- b - Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- c - Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- g - Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h - Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- i - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

*Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti (dorazi) në Zyren e Arkivës dhe Protokollit te Bashkise Peqin, me adrese Bulevardi “Mustafa Gjinishi” Peqin,*

**Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave për lëvizjen paralele duhet të bëhet brenda datës: 10/10/2019**

### **1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

---

Në datën **12/10/2019**, Bashkia Peqin do të shpallë në stenden e informimit te publikut, faqen zyrtare të internetit “www.peqini.gov.al” dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e lëvizjes paralele, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht nga Bashkia Peqin për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

### **1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA**

---

**Kandidatët do të testohen në lidhje me:**

- Njohuritë mbi Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”;

### **1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

---

**Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:**

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i çertifikimit nuk është kryer. Totali i ve për këtë vlerësim është 40 pikë.

**Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- a - Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b - Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c - Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën;

Totali i pikëve për këtë vlerësim është **60 pikë**.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “www.dap.gov.al”

## **1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Peqin do të shpallë fituesin në stenden e informimit të publikut, faqen zyrtare “www.peqini.gov.al” dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Bashkia Peqin, për rezultatet (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

## **2 NGRITJA NE DETYRE**

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë. Këtë informacion do ta merrni në faqen e Bashkisë Peqin dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit duke filluar nga data 25/10/2019

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë të një kategorie paraardhëse (vetëm një kategori më e ulët), të punësuar në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, që plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë dhe kërkesat e veçanta për vendin e lirë.

### **2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRË DHE KRITERET E VEÇANTA**

**Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e ngritjes në detyrë janë:**

- a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda kategorisë III-a, III-b, etj.;
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”.

**Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:**

- a- Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Shkenca Juridike. Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë;
- b- Të kenë të paktën 3 vjet përvojë pune në profesion;
- c- Të kenë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.

### **2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

**Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:**

- a - Jetëshkrim i plotësuar;
- b - Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- c - Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);

- d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- g - Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h - Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- i - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

*Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti (dorazi) në Zyren e Protokollit dhe Arshives të Bashkisë Peqin, me adrese Bulevardi "Mustafa Gjinishi" Peqin, Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave për procedurën e ngritjes në detyrë duhet të bëhet brenda datës: **15/10/2019***

### **2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

---

Në datën **25/10/2019**, Bashkia Peqin do të shpallë në stenden e informimit të publikut, faqen zyrtare të internetit "www.peqini.gov.al" dhe në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e ngritjes në detyrë si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e ngritjes në detyrë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Bashkia Peqin, për shkaqet e moskualifikimit (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

### **2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA**

---

**Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:**

- Njohuritë mbi Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë";
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996 "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës Civile i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore";
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike";

**Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

### **2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

---

**Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:**

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 40 pikë;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 20 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “www.dap.gov.al”

**2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Peqin do të njoftojë ata individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail). Bashkia Peqin do të shpallë fituesin në faqen zyrtare “www.app.gov.al” dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e ngritjes në detyrë, do të marrin informacion në faqen e Bashkise Peqin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” për fazat e mëtejshme të kësaj procedure:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak;
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Bashkise Peqin duke filluar nga data: 10/10/2019

**P/Sektorin e Burimeve Njerëzore**

**Përgjegjësi**

**/ Edlira Elezi /**

**KRYETARI I BASHKISE**

**/ Lorenc TOSKU /**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PEQIN

Nr. \_\_\_\_ .Prot.

Peqin, më 27.09.2019

**Lenda :** Shkrese percjellese

**Drejtuar :** Sherbimit Kombetar te Punesimit

**TIRANË**

Ne zbatim te ligjit nr. 152/2013, "Per nepunesin civil" i ndryshuar, dhe VKM nr. 242 date 18.03.2015 "Për plotesimin e vendeve te lira ne kategorine e ulet dhe te mesme drejtuese", bashkengjitur po ju dergojme për botim, ne forme te shkruar dhe elektronike ne adresen "vendetelirapune@shkp.gov.al", njoftimet per listen e fituesve të procedures së ngritjes në detyrë, per pozicionet ;

**1. Drejtor i Drejtorisë Juridike, Burimeve Njerezore dhe TIK, në Bashkinë Peqin**

**Konceptoi**  
**Pergjs.Sek.Bur.Njerezore**  
**/E.Elezi/**

**KRYETARI I BASHKISE**

**/ Lorenc TOSKU /**